



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. ... Prot.
4919

Tiranë, më 07.05.2018

UDHËZIM

Nr. 16, datë 07.05.2018

PËR

**ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2018,
SESIONI I DYTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, shkronja "a" dhe 51 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni e dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj (D3)	27 gusht 2018
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1)	30 gusht 2018
c) Matematikë (D2)	03 shtator 2018
d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2)	07 shtator 2018
2. Provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00.
 - a) Provimet e lëndëve me detyrim të zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 - b) Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.
3. Administrimi edhe procedurat për shpërndarjen dhe grumbullimin e materialeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni dytë, bazohen në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018, miratuar me Urdhrin nr. 672, datë 29.12.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, ndërsa 12 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të


vlerësohen me 37 pikë.

5. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, ndërsa 10 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 30 pikë.
6. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje, të hyjnë në provim në orën 11.00 dhe ta përfundojnë atë në orën 13.00.
7. Në provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:
 - a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultuan mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2017-2018 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 22 gusht 2018.
 - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2017, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore.
 - d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë të njësuar dokumentet shkollore nga MASR.
8. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 7, germa a dhe b, të plotësojnë Formularin A1 Z për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore.
9. Kandidatët/kandidatët e përcaktuar në pikën 7, germa c dhe d, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton DAR/ZA-ja e vendbanimit të tyre. Këta kandidatë të plotësojnë Formularin A1Z në datat 21-23 gusht 2018.
10. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, deri më 23 gusht 2018. Drejtori i DAR/ZA-së ta dërgojë këtë listë në QSHA në datën 24 gusht 2018.
11. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale. ZA Tropojë, ZA Lushnje dhe ZA Sarandë t'i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre. ZA Delvinë t'i zhvillojë provimet në qytetin e Sarandës.
12. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë.
13. Drejtori i DAR/ZA-së, brenda datës 20 gusht 2018, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë.
14. Në DAR ku numri i maturantëve/kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

15. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së he të institucioneve të vartësisë.
16. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it, në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Financave, Qendra Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, njësitë arsimore vendore dhe shkollat.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletore Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

